



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Handwritten signature in blue ink, likely of the Speaker of the Assembly, Gramoz Ruçi.*

Nr. 3478 Prot

Tiranë, më 30/11 2018

**Lënda:** Amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” lidhur me investimin në argjinaturave të lumenjve.

**Drejtuar:** **Zotit Gramoz RUÇI**

**KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim e miratim, në seancë plenare, një amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, me përmbajtje si më poshtë:

“Në nenin 10 të projektligjit, në tabelën 1 ku referohet ky nen, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Shtohen me 100 milionë lekë shpenzimet kapitale për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, për objektet e mbrojtjes nga përmbytja.
- Pakësohen me 100 milionë lekë shpenzimet korrente në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin “Përkujdesi Social”.


#### **ARSYETIMI I AMENDAMENTIT.**

Amendamenti në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” mbështetet në shqetësimin e ngritur nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat lidhur me dëmtimin e argjinaturave të lumenjve në dhjetor të vitit 2017 dhe shkurt të vitit 2018. Për të shmangur përmbytjet e mundshme, për zonat më të dëmtuara nga këto përmbytje, sidomos në lumenjtë Vjosë, Drinos, Osum, Shkumbin, Bunë, propozoj që në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” të shtohen shpenzimet kapitale me 100 milionë lekë, për objektet e mbrojtjes nga përmbytja.

Efeki i kësaj shtese propozoj të përballohet nga pakësimi me 100 milionë lekë i shpenzimeve korrente në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në programin “Përkujdesi Social”, nga fondet e parashikuara më tepër për “bonusin e lindjeve”.

**DEPUTETI PROPOZUES**

**Erion BRACE**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Erion Brace', is written over the printed name. The signature is stylized and includes a large, sweeping flourish that extends downwards and to the left.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Të nderuar Zotëri*  
*Gramoz Ruçi*  
*Kryetar*

Nr. 3777 Prot

Tiranë, më 30/11 2018

**Lënda:** Amendament për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

**Drejtuar:** **Zotit Gramoz RUÇI**

**KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim e miratim, në seancë plenare, një amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, me përmbajtje si më poshtë:

“Në nenin 10 të projektligjit, në tabelën 1 ku referohet ky nen, kufiri i shpenzimeve të vitit 2019, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pakësohet me 200 milionë lekë, në programin “Zhvillimi Rural, duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”, për të kompensuar të ardhurat e munguara nga ulja e TVSH për inputet bujqësore e blegtorale nga 20 për qind, në 10 për qind.

DEPUTETI PROPOZUES

**Erion BRAÇE**

*Erion Braçe*  
*18*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË  
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

*T. Gramoz Ruçi*  
*10/01/2018*

Nr. 3479 prot.

Tiranë, më 30/11 2018

**Lënda :** Amendament për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” për mbështetjen e personave me sindromën Down.

**Drejtuar: Zotit Gramoz RUÇI**

**KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim e miratim, në seancë plenare, një amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, me përmbajtje si më poshtë:

“Në nenin 10 të projektligjit, në tabelën I ku referohet ky nen, shpenzimet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin “Shërbimet e shëndetit dytësor” rriten me 25 milionë lekë. Efekti i kësaj shtese të përballohet nga pakësimi i shpenzimeve korrente në këtë ministri, në programin “Përkujdesi Social”, nga fondet e parashikuara më tepër për bonusin e lindjeve.

**ARSYETIMI I AMENDAMENTIT.**

Amendamenti mbështetet në kërkesën e paraqitur, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, nga Fondacioni “Down Syndrome Albania”, si përfaqësues i komunitetit të personave me sindromën Down në Shqipëri dhe i prindërve të tyre. Kjo kërkesë është mbështetur edhe nga Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë.

Fondacioni “Down Syndrome Albania” ka paraqitur kërkesën për sigurimin e mbështetjes buxhetore për rimbursimin e analizës gjenetike të kariotipit për foshnjat e lindura me sindromën

down (Suspect Trisomy 21). Aktualisht, kjo analizë nuk ofrohet nga asnjë institucion shëndetësor publik shqiptar dhe mund të kryhet vetëm në klinika apo spitale private në Tiranë, të cilat e dërgojnë për ekzaminim në laboratorë të tjerë jashtë Shqipërisë. Nëse foshnja me këtë diagnozë nuk arrin ta kryejë këtë analizë, nuk mund të paraqitet për vlerësim në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) dhe si rrjedhojë nuk përfiton dot pagesën për aftësinë e kufizuar. Kostoja e kësaj analize në institucionet shëndetësore private është shumë e lartë (rreth 180 euro). Shumë familje shqiptare, që kanë këtë problematikë, ndodhen në pamundësi financiare për kryerjen e kësaj analize të domosdoshme, por mjaft të kushtueshme për buxhetin e tyre familjar.

Sigurimi i mbështetjes buxhetore për këtë kategori të fëmijëve dhe të familjeve shqiptare është mjaft i rëndësishëm. Për këtë arsye, propozoj që deri ditën kur kjo analizë të kryhet nga institucionet shtetërore të vendit tonë, kostoja e saj të rimbursohet nga buxheti i shtetit (siç vepron për fishat e diabetit). Zbatimi i kësaj mase do të bëjë të mundur kryerjen e analizës specifike dhe përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar për këtë kategori të fëmijëve në nevojë.

Për të bërë të mundur këtë rimbursim, propozoj që buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të rritet me 25 milionë lekë, i destinuar për programin "Shërbimet e shëndetit dytësor". Efekti i kësaj shtese propozoj të përballohet nga pakësimi i shpenzimeve korrente në këtë ministri, në programin "Përkujdesi Social", nga fondet e parashikuara më tepër për bonusin e lindjeve.

**DEPUTETI PROPOZUES**  
**Erion BRACË**

